Bazuar në nenin 27, paragrafi (2), pika 6 të Statutit të Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz" të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e 16-të, të mbajtur më 10.6.2025, miratoi si vijon:

Rregullore për përsosje profesionale, arsimimin plotësues dhe specializimin e të punësuarve në IN "Orkestra e Muzikës Xhaz" të Republikës së Maqedonisë së Veriut

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohen të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në IN Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejmë: Orkestra e Muzikës Xhaz), në Institucionin Nacional Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, për përsosjen profesionale, arsimimin plotësues dhe specializimin, format, dinamikën dhe kushtet sipas të cilave ato mund të realizohen.

Neni 2

Përsosja profesionale, arsimimi plotësues dhe specializimi i të punësuarve në IN Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kanë për qëllim krijimin e kushteve për kryerje më të suksesshme dhe më cilësore të punëve dhe detyrave të punës që përfshihen në fushëveprimin e kompetencave të institucionit, si dhe ruajtjen, përkatësisht avancimin e aftësisë së punonjësit për punë në vendin e punës ku është sistemuar.

FORMAT E PËRSOSJES PROFESIONALE, ARSIMIMIT PLOTËSUES DHE SPECIALIZIMIT

Neni 3

Përsosja profesionale, arsimimi plotësues dhe specializimi realizohen nëpërmjet formave të mëposhtme:

- Provimi profesional;

- Studimet pasuniversitare;

- Studimet e doktoratës; dhe

- Forma të tjera të përsosjes dhe të specializimit.

Neni 4

(1) Cikli i dytë i studimeve (studime pasuniversitare, përkatësisht magjistër, master).
(2) Cikli i tretë i studimeve (studime doktorature) për:
    - Interpretim në instrument (instrumentet që janë pjesë përbërëse e Orkestrës së Muzikës Xhaz të RMV-së): trumpetë, trombon, saksofon, piano, kitarë, kontrabas, bateri/instrumente me goditje, kompozim xhaz dhe aranzhim.

(3) Studimet pasuniversitare dhe studimet e doktoratës duhet të trajtojnë dhe të hulumtojnë tema nga fushat:

- E drejta, ekonomia, komunikologjia, gazetaria dhe opinioni publik;

- Menaxhmenti, marrëdhëniet me publikun, informatika etj., të cilat do të kontribuojnë në rritjen e performancës dhe suksesit të institucionit në tërësi; dhe

- Fusha të tjera që janë me rëndësi për realizimin e qëllimeve, vizionit, misionit dhe detyrave të institucionit.

Neni 5

Format e tjera të përsosjes dhe specializimit janë: seminare, punëtori, konferenca, simpoziume, kongrese, këshillime dhe lloje të tjera të trajnimit profesional. Të punësuarit në Orkestrën e Muzikës Xhaz kanë të drejtë, por edhe detyrim, që nëpërmjet formave të tjera të përsosjes profesionale dhe specializimit, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në mënyrë të vazhdueshme të investojnë në njohuritë e tyre, në varësi të karakteristikave dhe specifikave të vendit të tyre të punës, me çka do të sigurojnë zhvillimin e tyre personal profesional, si dhe zhvillimin e institucionit në tërësi.

FINANCIMI I PËRSOSJES PROFESIONALE, ARSIMIMIT PLOTËSUES DHE SPECIALIZIMIT

Neni 6

Përsosja profesionale, arsimimi plotësues dhe specializimi i të punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV-së financohen nga mjetet e parashikuara për këtë qëllim në planin financiar të institucionit.

Neni 7

Përsosja profesionale, arsimimi plotësues dhe specializimi i të punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV-së mund të financohen edhe pjesërisht nga mjetet që do t'i miratohen punonjësit nga ana e Orkestrës së Muzikës Xhaz të RMV-së dhe pjesërisht nga burime dhe mjete të tjera (mjete personale, mjete nga sponsorët, donacione dhe të ngjashme).

KUSHTET SIPAS TË CILAVE MIRATOHEN MJETE PËR PËRSOSJEN PROFESIONALE, ARSIMIMIN PLOTËSUES DHE SPECIALIZIMIN

Neni 8

Mjetet për përsosje profesionale, arsimim shtesë dhe specializim, nëpërmjet formave të përsosjes profesionale, arsimimit shtesë dhe specializimit të përcaktuara në nenin 3, të kësaj Rregulloreje, miratohen nga ana e Këshillit drejtues, në bazë të kërkesës të paraqitur nga i punësuari në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV-së deri te drejtori.

Neni 9

Që Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz të RMV-së që të mundet t'i përgjigjet pozitivisht kërkesës së paraqitur, sipas nenit 8, të kësaj Rregulloreje, punonjësi duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

-Të jetë në marrëdhënie të rregullt pune në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV-së për të paktën dy (2) vjet; dhe

-Të kryejë punë në vendin e punës për të cilin kërkohet përsosje e vazhdueshme profesionale dhe/ose shkencore, arsimim shtesë, si dhe ndjekje e proceseve aktuale në fushën përkatëse, me qëllim fitimin e njohurive të veçanta profesionale dhe të thelluara, të nevojshme për kryerje më të suksesshme dhe më cilësore të detyrave të punës.

Neni 10

Për përsosjen profesionale, arsimimin shtesë dhe specializimin nëpërmjet formave të tjera të përsosjes profesionale dhe specializimit, të përcaktuara në nenin 5, të kësaj Rregulloreje, vendos drejtori, me iniciativën e tij ose mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga udhëheqësi i njësisë organizative, përkatësisht nga vetë punonjësi.

PROCEDURA PËR MIRATIMIN E MJETEVE PËR PËRSOSJE PROFESIONALE, ARSIMIM SHTESË DHE SPECIALIZIM

Neni 11

Kërkesa për miratimin e mjeteve për përsosje profesionale, arsimim shtesë dhe specializim, nëpërmjet formave të përsosjes profesionale, arsimimit shtesë dhe specializimit të përcaktuara në nenin 3, paragrafët 1, 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje (provimi profesional, studimet pasuniversitare dhe studimet e doktoratës), i paraqitet drejtorit, i cili kërkesën, së bashku me propozimin e tij, ia dërgon për miratim deri te KD në një nga mbledhjet e tij të rregullta. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për miratimin e mjeteve për përsosje profesionale, arsimim shtesë dhe specializim, përparësi do t'u jepet kërkesave për të cilat një pjesë e mjeteve është siguruar nga vetë punonjësi i Orkestrës së Muzikës Xhaz të RMV-së, në pajtim me nenin 7, të kësaj Rregulloreje. Nëse KD e pranon propozimin e drejtorit dhe e miraton kërkesën për ndarjen e mjeteve, drejtori do të nxjerrë vendim për miratimin e mjeteve për përsosje profesionale, arsimim shtesë dhe specializim.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet që lidhen me mjetet e miratuara për përsosje profesionale, arsimim shtesë dhe specializim, të përcaktuara në nenin 3, paragrafët 1, 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje, do të rregullohen më hollësisht me kontratë që do të lidhet midis Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe punonjësit – parashtrues të kërkesës.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TË PUNËSUARVE NË ORKESTRËN E MUZIKËS XHAZ TË RMV-SË NË LIDHJE ME MJETET E MIRATUARA PËR PËRSOSJE PROFESIONALE, ARSIMIM SHTESË DHE SPECIALIZIM

Neni 13

Punonjësi të cilit i miratohen dhe i paguhen mjetet për formën e përsosjes profesionale, arsimimit shtesë dhe specializimit të përcaktuar në nenin 3, paragrafi 1 i kësaj Rregulloreje, është i detyruar:

- Të kalojë provimin përkatës brenda një (1) viti nga dita e paraqitjes së aplikimit të parë për dhënien e provimit;

-Të mbetet në marrëdhënie pune në Orkestrën e Muzikës Xhaz për të paktën tre (3) vjet nga dita e kalimit të provimit; dhe

-Nëse e ndërpret marrëdhënien e punës para skadimit të afatit të paraparë në nënparagrafin 2 të këtij neni ose nuk e kalon provimin brenda afatit përkatës, është i detyruar t'ia kthejë Orkestrës së Muzikës Xhaz shumën e miratuar dhe të paguar, së bashku me kamatën ligjore, në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke filluar nga dita pasuese e ditës së fundit të skadimit të afatit për kalimin e provimit.

Neni 14

Punonjësi të cilit Këshillit drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz i miraton dhe i paguan mjetet për format e përsosjes profesionale, arsimimit shtesë dhe specializimit të përcaktuara në nenin 3, paragrafët 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje, është i detyruar:

-Në afat t'i përfundojë studimet pasuniversitare (master) brenda katër viteve, përkatësisht studimet e doktoratës brenda gjashtë viteve;

-Nëse nuk i përfundon studimet pasuniversitare ose studimet e doktoratës brenda afatit të përcaktuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 1 të këtij neni, t'ia kthejë Orkestrës së Muzikës Xhaz shumën e miratuar dhe të paguar, së bashku me kamatën ligjore, në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke filluar nga dita pasuese e ditës së fundit të afatit për përfundimin e studimeve pasuniversitare ose të doktoratës; dhe

-Të mbetet në marrëdhënie pune në Orkestrën e Muzikës Xhaz për të paktën katër vite pas përfundimit të studimeve pasuniversitare, përkatësisht të mbetet në marrëdhënie pune në Orkestrën e Muzikës Xhaz për të paktën gjashtë vite pas përfundimit të studimeve të doktoratës. Afatet e përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafin 1 të këtij Neni fillojnë të rrjedhin nga dita e regjistrimit në studimet pasuniversitare ose të doktoratës, për të cilat janë miratuar dhe paguar mjetet financiare nga Orkestra e Muzikës Xhaz.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Shkup, _____

Sashko Nikolovski,

kryetar i Këshillit Drejtues,

IN Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së